

VENDIM
Nr.207, datë 16.4.2004

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË DHËNIES ME KONCESION TË FORMËS “BOO”
DHE PËRCAKTIMIN E ORGANIT SHTETËROR TË AUTORIZUAR PËR PËRGATITJEN
DHE REALIZIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, PËR NDËRTIMIN E IMPIANTIT
PËR PËRPUNIMIN E MBETJEVE TË NGURTA URBANE NË QARQET TIRANË-DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 pika 5,5 dhe 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe Ministrisë të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për dhënien me koncesion të përpunimit të mbetjeve të ngurta urbane, në qarqet Tiranë-Durrës, me shoqëritë e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi mbi propozimin e ofertave të pakërkua.

2. Koncesioni të jetë i formës “BOO” (ndërtim-pronësi-shfrytëzim).

3. Organi shtetëror i autorizuar (OSHA) për negocimin dhe nënshkrimin e kontratës të jenë Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit.

4. Organi shtetëror i autorizuar bën vlerësimin e ofertave të paraqitura nga shoqëritë e mësipërme, në përputhje me kriteret e mëposhtme:

- programi i investimeve;
- skema e financimit të koncesionit dhe ajo e financimit të veprimtarisë së koncesionarit;
- kriteret dhe parametrat shoqërore, ekonomike dhe mjedisore;
- kërkesa për lehtësi dhe foma mbështetjeje të veçanta nga Këshilli i Ministrave;
- kërkesa të veçanta për sektorin e përpunimit të mbetjeve urbane.

5. Ngarkohen Ministri i Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi nr.341, datë 11.7.2002 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e organeve shtetërore të autorizuar për përgatitjen dhe realizimin e kontratës së koncesionit, për përpunimin e mbetjeve të ngurta urbane, të qarqeve Tiranë-Durrës”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano